

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PAJISJE TË ALARM-MONITORINGUT PËR SHËRBIMIN “BUTONI I URGJENCËS”

Projekti: Zhvillimi i shërbimeve afariste për kujdesin dhe mbështetjen e integruar në KKRMV, mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim, Kryqi i Kuq Austriak, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryqi i Kuq Zvicëran

Qëllimi i përgjithshëm: Prokurimi dhe dorëzimi i 60 pajisjeve të alarmit për Butonin e Urgjencës, jo më vonë se dy javë pas nënshkrimit të marrëveshjes

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 25.08.2021

Mënyra e dorëzimit: Ofertuesi dorëzon shembullin në origjinal në kovertë të mbyllur që përmban emrin e ofertuesit me adresë të plotë dhe të saktë. E nejtja adresohet në KKRMV – Arkivi, në Bul. Koço Racin nr.13, 1000 Shkup, me shënim të numrin arkivor **0507-766**

1) Pasqyra e objektivave

Me trendin në rritje të plakjes së popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kërkesa për kujdes të integruar dhe shërbime mbështetëse për gratë dhe burrat e moshuar aktualisht është shumë më e lartë se furnizimi. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KKRMV) është një ofrues i njohur kombëtar, me përvojë profesionale në ndihmën shëndetësore dhe sociale për burra dhe gra të moshuara që kanë nevojë për ndihmë. Sidoqoftë, KKRMV gjithashtu mbështetet në ndihmën e huaj për të vazhduar të ofrojë shërbime kyçe për mbështetjen e jetës së grave dhe burrave më të moshuar me shëndet dhe dinjitet. Kjo mbështetje në ndihmë është një sfidë për sigurimin e shërbimeve cilësore në planin afatgjatë.

Projekti “Zhvillimi i shërbimeve afariste për kujdesin dhe mbështetjen e integruar në KKRMV” mbështet Kryqin e Kuq që të vazhdojë të ofrojë sigurim cilësor të kujdesit të integruar dhe shërbimeve mbështetëse për gratë dhe burrat e moshuar duke zhvilluar një model gjithëpërfshirës afarist për shërbime të qëndrueshme dhe dorëzim brenda organizimit. Modeli afarist përbëhet nga tri shtylla për të ndihmuar të moshuarit në nevojë, si dhe për të gjeneruar të ardhura për të financuar shërbimet shëndetësore dhe sociale afatgjata. Projekti synon të çojë drejt pavarësisë dhe të vendosë bazat për sigurimin e vetëqëndrueshëm të shërbimeve.

Shtylla e dytë brenda projektit është pilotimi i shërbimit të “Butonit të Urgjencës”.

60 burra dhe gra të moshuar në Maqedoni do të zgjidhen si përdorues të modelit të sapoprezantuar, me një pagim mujor për përdorimin e shërbimit “Butoni i Urgjencës” në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Butoni i urgjencës do të jetë një shërbim 24/7, të cilin përfituesit nga popullsia e moshuar do të jenë në gjendje ta përdorin në shtëpitë e tyre, duke shtypur pajisjen e alarmit, e paraparë ta mbajnë afër vetes, sa herë që janë në një gjendje që nuk është e rrezikshme për jetën, por është mjaft serioze dhe ka nevojë për urgjencë, ndihmë të parë dhe mbështetje (dëmtim, thyerje të gjymtyrëve, rënie aksidentale, gjakderdhje plage, dëmtime nga djegia, gjendje urgjente mjekësore, reaksione alergjike, etj.). Përmes pajisjeve ata do të jenë në gjendje të komunikojnë me Operatorët nga Qendra e Kontaktit, e cila do t’u

sigurojë atyre një qasje të shpejtë dhe efikase në mbështetjen dhe ndihmën e duhur, nga profesionistë dhe Shpëtimtarët në Emergjencat e KKR MV-së. KKR MV do të krijojë një shërbim efikas për Butonin e Urgjencës dhe është frymëzuar nga përvojat austriake dhe zvicerane për funksionimin efikas të shërbimeve të kujdesit për të moshuarit.

Projekti është hartuar si Aleancë Strategjike me Agjencinë Austriake të Zhvillimit (ADA). Menaxhimi bëhet nga Kryqi i Kuq Austriak, ndërsa Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KKR MV) zbaton projektin.

1) SPECIFIKIMI TEKNIK I PAJISJEVE TË OFRUARA

- Entitetet e interesuara – aplikantët, duhet të paraqesin dokument me specifikime teknike të renditura të cilat i kanë pajisjet e ofruara.

2) CERTIFIKATAT E NEVOJSHME PËR ENTITETET NDËRKOMBËTARE

- Për entitetet (aplikantët) ndërkombëtare, kërkohet të kenë produkt të zhvilluar në vendet e BE-së/EFTA-s dhe të sigurojnë një deklaratë të origjinës së pajisjeve nga kompania aplikuese.
- Për entitetet (aplikantët) ndërkombëtare, është e detyrueshme të sigurohet certifikatë EFTA/EUR.1.

3) ENTITETET E PËRSHTATSHME DUHET T’I PËRMBUSHIN KRITERET NË VIJIM:

- Të jetë kompani në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose një vend tjetër në Evropë
- Të jetë në gjendje të sigurojë faturë pa tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH) sipas rregullave kombëtare fiskale
- Të jetë në gjendje të kryejë dorëzimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Të jetë në gjendje të sigurojë certifikatë të origjinës së BE-së për pajisjet e alarmit, duke përfshirë garanci për pajisjet prej të paktën 1 viti

4) SI TË APLIKOHET?

Subjektet e interesuara - aplikantët, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Ofertë financiare për 60 pajisje alarmi me kostot e përfshira për dorëzimin e tyre
- Dokument me specifikimet teknike të pajisjeve të alarmit
- Manual/Udhëzim për funksionimin dhe përdorimin e pajisjeve të alarmit
- Portofol profesional të kompanisë
- Certifikatë të regjistrimit nga regjistri qendror i kompanive
- Për aplikantët ndërkombëtarë kërkohet të kenë produkt të zhvilluar në vendet e BE-së/EFTA-s dhe të sigurojnë deklaratë të origjinës së mallrave/shërbimeve nga kompania
- Për aplikantët ndërkombëtarë, është e detyrueshme të sigurohet certifikatë EFTA/EUR.1

5) MËNYRA E PAGESËS:

- Pagesa do të bëhet nga KKR MV, jo më vonë se 14 ditë pas dorëzimit dhe mbërritjes së plotë të pajisjeve në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.